

V E N D I M
Nr. 492, datë 19.9.2000

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË TENDERIMIT, PËR SHITJEN E PAKETËS SË
AKSIONEVE (90 PËR QIND), TË ZOTËRUARA NGA SHTETI NË “QUMËSHTI AJKA”,
SH.A., TIRANË, DHE SHPALLJEN FITUES TË TENDERIT TË “ALDOSCH” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit”, të paragrafit të dytë, të nenit 3, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, të vendimit nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që zotërohen nga shteti”, ndryshuar me vendimet nr.122, datë 18.3.2000, nr.179, datë 13.4.2000 dhe nr.456, datë 17.8.2000, të Këshillit të Ministrave, si dhe të vendimit nr.463, datë 6.10.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e tenderit, si formë të privatizimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, ndryshuar me vendimin nr.123, datë 18.3.2000, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve, prej 90 për qindsh, të zotëruara nga shteti, në “Qumështi Ajka”, sh.a., Tiranë, dhe shpalljen fitues të tenderit të “Aldosch”, sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit të lidhë kontratën e shitjes së paketës së aksioneve të “Qumështi Ajka”, sh.a., Tiranë, me fituesin e tenderit “Aldosch”, sh.p.k.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta